

varrosur mbetjet mortore të Zymberit në varrezat e Krushecit/Kruševac.

Burimet: deklarata H.B, FDH-12903; KKMKRFJ, *Personat.*, FDH-10832; KMDLNI, *Buletini*, num. 7, prill-qershor 1998, 143, FDH-23816; USCG KGDH, *Regjistri.*, FDH-8817; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), EX.298.1.4, FDH-30924; FHP, *Haški tribunal, Sudeenje Slobodanu Miloševicæu*, II, 811.

Ekrem (Ukë) Binakaj

(16.07.1958, shqiptar nga Krysheci/Kruševac, komuna e Pejës/Peç)

Ekremi u zhduk më **31.05.1998** në **Krushec/Kruševac**, në rrethana të pasqaruara. Për fatin e tij nuk dihej asgjë deri më 11.09.1998, kur policia e zbuloi trupin e tij në Krushec/Kruševac. Obduksioni ka konstatuar se atë e kishin vvarë me armë zjarri.

Burimet: USCG KGDH, *Regjistri.*, FDH-8817; KKMKRFJ, *Personat.*, FDH-10832; SMIP, *Teroristički.*, III, 913; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), EX.298.6.5, FDH-30909; deklarata A.B, FDH-31889.

Shaban (Binak) Muçaj

(25.04.1935, shqiptar nga Lluka e Epërme/Gornja Luka, komuna e Deçanit/Deçani, bujk, i martuar)

Shabani jetonte në Llukën e Epërme/Gornja Luka. Në muajin **qershor të vitit 1998**, ai shkoi te dentisti në **Pejë/Peç**. Ditën e nesërme, një i afërm e ka njoftuar familjen se Shabanin e kanë keqtrajtuar rëndë te lumi *Lumbardhë/Bistrica*, në afërsi të kishës ortodokse në Pejë/Peç, dhe se ai gjendej në spital, në gjendje të pavetëdijshme. Shabanin në këtë gjendje, e kanë gjetur në rrugë disa fëmijë dhe, për këtë, e kanë njoftuar menjëherë Bashkësinë Islame (Vakëf). Pas tri ditësh, Shabani ka ndërruar jetë nga pasojat e keqtrajtimit të rëndë fizik. Po atë ditë, disa njerëz të Vakëfit e kanë varrosur Shabanin në varrezat e fshatit Katundi i Ri/Pašino Selo.

Burimi: deklarata S.M, FDH-17082.

Ukë (Rexhep) Thaçi

(1972, shqiptar nga Kosuriqi/Kosurić, komuna e Pejës/Peç, i papunë, i pamartuar)

Uka jetonte në bashkësi familjare me nënën, vëllain dhe familjen e tij [**Kosuriq/Kosurić**]. E kanë vvarë më **2.06.1998**, në rrethana të pasqaruara. Para vrasjes së tij, Uka kishte dal në oborr dhe, më pas, e ëma dhe kunata kanë dëgjuar disa të shtëna. Ato dolën menjëherë jashtë dhe e gjetën Ukën të qëlluar me plumbat në kokë dhe në zemër. Atëbotë, në fshat nuk gjendeshin forcat serbe. Ukën e kanë varrosur në varrezat e Kosuriqit/Kosurić më 3.06.1998.

Burimet: deklarata T.T, FDH-35268; USCG KGDH, *Regjistri.*, FDH-8817; FHP, *Haški tribunal, Sudeenje Slobodanu Miloševicæu*, II, 810, 811; KKMKRFJ, *Personat.*, FDH-10832; SMIP, *Teroristički.*, III, 911; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), EX.298.33.3, FDH-30888; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), EX.298.1.4, FDH-30924; *Teroristi muçili i ubili 67 nedužnih civila*, Politika, 14.9.1998, <http://www.arhiva.srbija.sr.gov.yu/vesti/1998-09/17/5250.html>.

Magribe (Sylejman) Kajolli

(17.01.1971, shqiptare nga Peja/Peç, stiliste, e pamartuar)

Magribe Kajolli ka jetuar me prindërit e vetë në lagjen *Dardania II/Brežanik II* në Pejë/Peç. Në datën **17.06.1998**, rreth orës 13:00, ajo u nis për të aderuar në UÇK në fshatin **Loxhë/Loda**. Nga ajo ditë, familjarët nuk e kishin parë kurrë më. Më vonë, i afërm i familjes Kajolli, Bahar Bajri, e ka njoftuar familjen se Magribja kishte arritur në Loxhë/Loda dhe se e kishte veshur uniformën e UÇK-së. Pas përfundimit të luftës, familjarët kanë tentuar të mësonin për fatin e saj, duke u interesuar nëpër shtabe të ndryshme të UÇK-së, por pa sukses. Në regjistrin e KNKK-së për persona të zhdukur, rasti i Magribes është i evidentuar në lëndën që e mban numrin BLG-802129-01.

Burimet: deklarata S.K, FDH-15443; KNKK, *Persona të zhdukur.*, FDH-9795.

Izet (Šabo) Gutic

(5.11.1958, boshnjak nga Raushiqi/Raušić, komuna e Pejës/Peç, elektrikist, tre fëmijë)

Vučić (Zarija) Vuković

(10.10.1961, serb nga Duboviku/Dubovik, komuna e Deçanit/Deçani, punëtor, tre fëmijë)